



SHËRBIMI I BOTIMEVE DHE BIBLIOTEKËS PARLAMENTARE

Figura kombëtare
(muaji tetor)

informacion

tetor / 2025



**Instituti
Parlamentar**

5 tetor

Sulejman Delvina (5 tetor 1884-1 gusht 1932) veprimtar politik, kryeministër i qeverisë, që doli nga Kongresi i Lushnjës.

8 tetor

ZOGU Ahmet (Mbreti Zog i Parë), (8 tetor 1895–9 prill 1961). Themelues i Mbretënisë Shqiptare, President dhe Kryeministër i Shqipërisë, personalitet politik e ushtarak. Kryeministër i Shqipërisë (1922-1924), President i Shqipërisë (1925-1928). Mbret i Shqipërisë (1928-1939).

12 tetor

FINO Bashkim (12 tetor 1962–2021). Kryeministër i Qeverisë së Pajtimit Kombëtar, veprimtar politik. Deputet i Kuvendit të Shqipërisë që nga v. 1997.

13 tetor

Dritëro Agolli (13 tetor 1931 -3 shkurt 2017) poet, prozator, publicist dhe politikan shqiptar. Deputet në disa legjislatura.

MIGJENI (Millosh Gjergj Nikolla, (13 tetor 1911–26 gusht 1938). Poet dhe prozator.

14 tetor

GJEÇOVI Shtjefën Konstandin (Mëhill Konstandin Gjeçi-Kryeziu, (12 korrik 1874-14 tetor 1929). Veprimtar i lëvizjes kombëtare, etnolog, arkeolog dhe shkrimtar, klerik françeskan. Universiteti i Lajpcigut i dha titullin “Doctor honoris causa”. Është dekoruar me Urdhrin “Për veprimtari patriotike” dhe me Urdhrin “Naim Frashëri” të kl. I

15 tetor

FRASHËRI Eshref (15 tetor 1874–1938). Veprimtar politik. U zgjodh Kryetar i Parlamentit Shqiptar që doli nga zgjedhjet e 5 prillit 1921. Më 1925 u zgjodh senator dhe në shtator të atij viti u caktua kryetar i Senatit. Në v. 1932 u zgjodh përsëri deputet i parlamentit.

16 tetor

HOXHA Enver (16 tetor 1908 -11 prill 1985). Udhëheqës i Partisë Komuniste dhe më pas i Partisë së Punës të Shqipërisë. Udhëhoqi Luftën ANÇ dhe drejtoi shtetin shqiptar pas luftës. Pas çlirimit u zgjodh deputet në të gjitha legjislaturat dhe anëtar i Presidiumit të Kuvendit Popullor. Hero i Popullit, Hero i Punës Socialiste etj.

20 tetor

Frashëri Naim (25 maj 1846 -20 tetor 1900) poet, mendimtar iluminist, veprimtar i arsimit

kombëtar dhe i kulturës së Rilindjes Kombëtare. Ai u bë figura qendrore e Rilindjes Kombëtare dhe u pagëzua për së gjalli si “Apostull i Shqiptarizms”. Ka marrë Çmimin e Republikës të shkallës së parë.

23 tetor

At Gjergj Fishta (23 tetor 1871 - 30 dhjetor 1940) Poet, dramaturg, prozator, estet, publicist, klerik i lartë, politikan. Ka qenë deputet, zëvendëskryetar i legjislativit shqiptar më 1921 dhe po ashtu kryetar i komisionit për hartimin e alfabetit në Kongresin e Manastirit. Është ndër themeluesit e Komisionit Letrar (1916). Gj.F. qe sekretar i përgjithshëm i delegacionit shqiptar në Konferencën e Paqes në Paris më 1919, si dhe përfaqësues diplomatik i shtetit shqiptar ndër disa konferenca ballkanike gjatë viteve '30. U cilësua “Homeri shqiptar”. Është dekoruar me Urdhrin “Nderi i Kombit”.

Abdyl Frashëri (29 gusht 1839 - 23 tetor 1892) atdhetar, demokrat i shquar, ideolog i Rilindjes Kombëtare, një nga udhëheqësit e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.

Shënim:

Emrat dhe datat janë marrë nga Fjalori enciklopedik shqiptar (3 vëllime), Tiranë, 20008

Të gjitha datat me ngjyrë të kuqe janë marrë në wikipedia, pasi nuk gjendeshin te burimi i mësipërm, ku ishin vetëm vitet.